



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:195262
Datë: 05.03.2024
Numri i dokumentit: 05413042

C.nr.1373/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit-të miturit E. K. nr. personal ..., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor prindi Sh. K., nr. personal ..., të dy nga Komuna e Podujevës, të cilët i përfaqëson e autorizuar "A. I." SH.P.K., e të cilën e përfaqësojnë Z. I., A. I., J. I dhe B. D., avokat nga Prishtina, me autorizim, kundër të paditurës K. S. "S. U. G. A." SH.A. nga Prishtina, baza e kontestit Kompensim dëmi, me vlerë kontesti: 2,500.00 euro, jashtë seancës me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit-të miturit E. K. nr. personal ..., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor prindi Sh. K., nr. personal ..., të dy nga Komuna e Podujevës, e ushtruar kundër të paditurës K. S. "S. U. G. A." SH.A. nga Prishtina, për Kompensim dëmi, të pësuar në aksidentin e datës 28.08.2023.

Secili palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata lidhur me çështjen konkrete juridike pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe shkresave të lëndës, konstaton se paditësi me parashtresën e datës 04.03.2024, ka theksuar se e tërheqë padinë me numrin e lartë theksuar për kompensim dëmi, ndaj të paditurës, për arsye se lidhur me këtë çështje kemi arritur pajtim jashtëgjyqësore me të paditurën.

Gjykata, pas pranimit të parashtresës për tërheqjen e padisë nuk veproi konform nenit 261.2 të LPK-së, i cili ka përcaktuar se: "*Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë.*", në rastet kur i padituri paraqet në gjykatë përgjigje në padi, ngase vlerësoi se me tërheqjen e padisë nga vetë paditësi për çështjen kontestuese edhe e paditura nuk ka ndonjë arsye që të kundërshtoi tërheqjen e padisë.

Andaj, si rezultat i kësaj, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në mbështetje të nenit 261.1, 2 dhe 3 si dhe nenit 450 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore të Kosovës.

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1373/2023 më datë 05.03.2024**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesë, në afatin prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.